



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës
Komiteti për Politikë dhe Financa
01 Nr.060-5456/2018
Gjakovë, më 19.03.2018, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla e vogël

PROCESVERBALI

Nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa

Të pranishëm ishin këta anëtarë të KPF-së: z. Anton Shala , Haxhi Sejdiu, znj. Florentina Gjergjaj, z. Bekim Jupa , z. Fazli Hoxha, znj. Diana Qarkaxhia , znj. Hana Zeka, z. Bekim Ermeni, z. Agon Batusha.

Të pranishëm të tjerë: z. Kristë Gjokaj , Komandant i Stacionit Policor në Gjakovë, z. Ramadan Hoti Nënkyetar i Komunës së Gjakovës z. Durim Halilaj, z. Arben Bakalli z. Lulzim Haxhiu, znj. Blerta Qela, përfaqësuesja e ZKKK-së znj. Pranvera Kershaj, zyrtar për informim, përfaqësues të OSBE-së dhe të OJQ-ve, media lokale: TV Syri, Radio Gjakova, dhe media të shkruara.

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: **z. Anton Shala** .

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të pranishëm të Komitetit për Politikë dhe Financa sot do ta kemi mbledhjen e dytë për vitin 2018, Të pranishëm në këtë mbledhje janë: 9 , anëtarë, andaj meqë ekziston kuorumi po fillojmë me mbledhjen.

Për këtë mbledhje është propozuar rendi i ditës, sipas ftesës të cilën e keni marruar, a ka dikush ndonjë vërejtje apo sugjerim.

Kryesuesi: Meqenëse se nuk ka diskutime e qes në votim miratimin e rendit të ditës sipas ftesës që e keni marrë, kush është: Për, Kundër, Abstenim.

Nga anëtarët e pranishëm unanimisht u votua pro miratimit të rendit të ditës sipas ftesës që e keni marrë .

Pas votimit të bërë u miratua ky:

R E N D I T E

- 1.Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me dt. 14.02.2018
- 2.Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit për periudhën Mars – Dhjetor 2018
- 3.Miratimi i Planit për transparence në Komunën e Gjakovës 2018
- 4.Miratimi i Planit të punës së KKS-së 2018
- 5.Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës së Gjakovës për vitin 2017
- 6.Bartja (rialokimi) i buxhetit të pasqepnuar nga viti i kaluar në vitin 2018
- 7.Themelimi i Komitetit për Shërbime Publike (KPSH)

8. Themelimi i Komisionit të Ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale .
9. Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 910/0, Zk Firzë në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).
10. Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 164/0, Zk Trakaniq në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).
11. Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1186/0, Zk Cermjanë në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).
12. Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1116/2, Zk Gjakovë qytet në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).
13. Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 113/0, Zk Pjetërshan në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).
14. Të Ndryshme

1. Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me dt. 14.02.2018

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës kemi Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me dt. 14.02.2018, andaj e Hapi diskutimin a ka dikush ndonjë vërejtje ose sugjerim sa i përket procesverbalit .

Kryesuesi: Pasi që nuk ka diskutime e qes në votim, miratimin e Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me dt. 14.02.2018 **Kush është Për, Kundër , Abstenim**
Nga anëtarët e KPF-së unanimisht u votua pro këtij procesverbali nga mbledhja e kaluar .

2. Pika e dytë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit për periudhën Mars – Dhjetor 2018

Kryesuesi : Për këtë pikë të rendit të ditës kemi Shqyrtimin e Planit të Punës së Kuvendit për periudhën Mars – Dhjetor 2018, draft dokument in ju kemi dërguar me kohë ky dokument është hartuar pas takimit me përfaqësuesin e DEMOS dhe konsultimeve me zyrën e Kryetarit të Komunës dhe drejtorive dhe zyrave komunale, është një plan pune që është i domosdoshëm ku janë të parapara pikat e rëndësishme sipas periudhave të caktuara kohore dhe ne kemi bërë përpjekje që ti prezantojmë të gjitha ato pika që janë të obligueshme dhe janë të domosdoshme për komunën e Gjakovës dhe janë parapara edhe disa raporte nga drejtoritë dhe Ndërmarrjet Publike , andaj e hapi diskutimin për këtë pikë .

z. Bekim Ermeni : Kemi kërkuar edhe në mbledhjen e kaluar që të kemi Planin e Punës së Kuvendit dhe informatën e Ekzekutivit për vitin 2018 dhe në këtë dokument pika e parë tregon mos harmoni sepse nuk është paraparë që të kemi për këtë mbledhje ndërsa sot nuk e kemi këtë pikë. Ne në mbledhjen e Kuvendit do të reagojmë dhe do të kërkojmë që të kemi planin e punës së ekzekutivit të jenë të prezantuara në detaje Plani i punës së Ekzekutivit përfshirë Planin dinamik, Planin e Investimeve Kapitale, i harmonizuar me planin e prokurimit, plani i subvencioneve, sepse detyrë e legjislativit është me e monitorua ekzekutivin dhe ne ende nuk e kemi planin e punës andaj nuk kemi as si te monitorojmë. Kërkoj që të harmonizohet plani i punës së kuvendit dhe të jetë Informata e kryetarit dhe të drejtoreshave të Komunës.

Kryesuesi: Ne e kemi paraparë në Planin e Punës së Kuvendit që Informata e Ekzekutivit të prezantohet në Mbledhjen e parë të Kuvendit dhe do të kemi këtë pikë mirëpo toni dhe mënyra e

reagimit të z. Ermeni është paksa i zëshëm dhe kuptohet se është në opozitë prandaj ne duhet të ndihmojmë proceset e mira dhe të jemi të kujdesshëm në reagime. Plani i Punës së Kuvendit ka qenë dashur që të miratohet në fund të vitit të kaluar nga qeverisja e kaluar dhe kjo është arsyeja që jemi vonuar mirëpo për vitin e ardhshëm është i parapara që të miratohet dhe e keni edhe në këtë plan të punës si pikë të rendit të ditës .

z. Agon Batusha: Unë mendoj se duhet të kemi planin e ekzekutivit që të diskutojmë për atë pikë sepse nuk kemi mundësi të marrim qëndrim pa e shqyrtuar dokumentin .

Kryesuesi: Ne e kemi parapara në Planin e Punës të Kuvendit edhe Informatën Kryetarit për Punën e Ekzekutivit andaj ajo pikë është si pikë e parë për mbledhjen e Kuvendit .

z. Bekim Jupa: Ne këtu të gjithë jemi nga Politika andaj e kuptoj se duhet të bëhet edhe opozitarizëm mirëpo ne e kemi kërkuar që të kemi në rend dite edhe planin e punës së Kuvendit dhe sot e kemi për shqyrtim ndërsa Informata e Ekzekutivit është e parapara për mbledhjen e kuvendit për këtë muaj .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime e qes në votim që kjo pikë të kalojë për diskutim në Mbledhjen e radhës së Kuvendit, Nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

P e r f u n d i m

I. Aprovohet Plani i Punës së Kuvendit për periudhën Mars – Dhjetor 2018

II. Ky përfundim së bashku me materialin dhe dokumentin e përgatitur të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës

3. Pika e tretë e rendit të ditës: Miratimi i Planit për Transparencë në Komunën e Gjakovës 2018

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Miratimi i Planit për transparencë në Komunën e Gjakovës 2018, është një obligim që rrjedh nga Udhëzimi Administrativ për transparencë në Komuna si dhe rregullorja e Kuvendit të Komunës për Transparencë në Komunën e Gjakovës me çka edhe Udhëzimi Administrativ edhe rregullorja i sqarojnë në detaje këto veprime që janë të parapara në këtë dokument i cili kërkohet të miratohet në Kuvend, për sqarime e ftoj **znj. Blerta Qela** ta merr fjalën

znj. Blerta Qela : Rregullorja komunale për transparencë në Komunën e Gjakovës e obligon Komunën që të hartoj planin e punës për transparencë në bazë vjetore si dhe në nenin 11 të udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna e obligon të njëjtën gjë, duke u nisur nga ky obligim grupi punues e ka hartuar këtë dokument ku qëllimi kryesor është që të avancohet transparenca e Komunës e Gjakovës , Ky Plan është i ndarë në 6 objektiva ku secila objektivi ka edhe aktivitete përdëllese që do të ndërmerren nga zyrtarët përgjegjës të komunës me qëllim të rritjes së transparencës në komunë

z. Bekim Ermenei: Ky dokument është mirë i hartuar dhe nuk kemi ndonjë vërejtje por kërkoj sqarime sepse këtu disa herë shënon se do të jenë në Wb Faqe do të jetë transparente kurse të gjithë e dimë se Faqja e Komunës që nga qeverisja e kaluar ende nuk është funksionale

z. Arber Gola : Faqja Zyrtare e Komunës është në funksion dhe nga java e kaluar mundeni të keni qasje në të .

znj. Diana Qarkaxhija : Nga nëntori as Gjakova Portal nuk është në funksion dhe në DKA e vetmja mënyrë e publikimit është tabela e shpalljeve , qasje tjera nuk ka aspak.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime e qes në votim që kjo pikë të kalojë për diskutim në Mbledhjen e radhës së Kuvendit, Nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

P ë r f u n d i m

I. Aprovohet Plan i për transparence në Komunën e Gjakovës 2018

II. Ky përfundim së bashku me materialin dhe dokumentin e përgatitur të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës

4. Pika e katërt e rendit të ditës: Miratimi i Planit të punës së KKSB-së 2018

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës kemi Miratimin e Planit të Punës së KKSB-së për vitin 2018, draft Planin e keni marrë me materialin e mbledhjes. Miratimi i këtij dokumenti është i paraparë në Udhëzimin Administrativ për Punën e KKSB-së andaj për sqarime e ftoi Komandantin e Stacionit Policor në Gjakovë z. Kristë Gjokaj që ta merr fjalën .

z. Kristë Gjokaj : Në javën e kaluar është mbajtur takimi i KKSB-së me përbërjen e re dhe pika e parë e rendit të ditës ka qenë themelimi i grupit Punues për hartimin e Planit të Punës së KKSB-së për vitin 2018 , dhe ne jemi takuar dhe e kemi hartuar këtë dokument. Ku janë paraparë 15 objektiva dhe shumë aktivitete brenda këtyre objektivave. KKSB-ja është organ këshillëdhënës në aspektin e sigurisë dhe k[to pika janë të përpara në këtë plan jemi fokusuar në aspektin e sigurisë , pikat kryesore që janë paraparë janë siguria e përgjithshme , siguria në Shkollë me fokus të veçantë kundër mjeteve narkotike që është edhe objektivi i paraparë edhe nga Kryeministri i vendit , shtimi i numrit të sigurisë në afërsi të shkollave, siguria në komunikacion, trajtimi i qeneve endacak, dhuna në familje është paraparë si objektiv i veçantë dhe dua ta potencoj se dhuna në familje nuk ka rritje por ka rritje raportimi i dhunës në familje, kemi paraparë objektivat kundër ekstremizmit të dhunshëm që shprijë në terrorizëm , kemi paraparë fushata të ndryshme sensibilizuese .

z. Bekim Jupa: Unë kërkoj sqarime lidhur me dukurin e lëmosh kërkuesve sepse kemi një numër të madh në Komunën e Gjakovës dhe në bazë të asaj që flitet nga qytetarët ata veprojnë në mënyrë të organizuar andaj si e kemi paraparë të luftohet kjo dukuri në komunën e Gjakovës .

z. Kristë Gjokaj: Kjo është një dukuri negative që ne në bashkëpunim me Komunën dhe organizata tjera jemi marrë vazhdimisht por është një dukuri problematike ku ne disa herë i largojmë nga qyteti por nuk kemi ku ti vendosim, kemi bërë përpjekje edhe me Qendrën për Punë sociale por ende nuk kemi gjetur një zgjidhje . Sa i përket atyre që veprojnë në mënyrë të organizuar kemi disa raste që ne i kemi dëbuar për në vendin e origjinës që ka qenë Shqipëria.

Znj. Florentina Gjergjaj: Në objektiven nr. 7 parandalimi mbrojtja dhe luftimi i trafikimit me qeneje njerëzore, dhe parandalimi i dhënës në familje tek aktivitetet është paraparë vetëm mbajtja e ligjëratave në shkollë , andaj duke pasur parasysh që shpesh herë nxënësit janë ata që përjetojnë dhunë në familje mendoj se kishte me qenë më mirë që të shtohet aktiviteti që do të sensibilizonte edhe opinionin më të gjerë përpos nxënësve që shpeshherë janë viktimë e jo shkaktar i dhunës.

z. Kristë Gjokaj: Kjo objektiv ka qenë dhe do të mbetet në vazhdimësi ne e kemi paraparë si aktivitet mbajtjen e ligjëratave në shkollë , mirëpo këshillat dhe sugjerimet e juaja janë të mirëseardhura

z. Haxhi Sejdi: Unë kam një pyetje se a keni konstatuar se nga çka po shkaktohet dhuna në familje, në mungesë të standardit po por mendoj se edhe nga substancat narkotike si dhe nga lojërat e fatit , andaj çfarë keni marrë në këtë drejtim apo çka keni planifikuar .

z. Kristë Gjokaj: Dhuna në familje është një fenomen në vazhdimësi ka faktor të ndryshëm dhe pajtohen se gjendja ekonomike është njëri nga shkaktohet por duhet të kemi një ngritje të vetëdijes së qytetarëve në aspekte të ndryshme , andaj konsideroj se vetmja zgjidhje është sensibilizimi i qytetarëve , ne që nga themelimi i i Policisë së Kosovës dhe e kemi edhe njësitin e veçantë për dhunën në familje, nuk ka rritje të dhunës në familje por ka vetëm rritje të raportimit .

kryesuesi: Kuvendi i Komunës në këtë muaj me 8 Mars ka mbajtur mbledhje të Jashtëzakonshme ku është diskutuar për këtë temë dhe janë nxjerrë disa rekomandime .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime e qes në votim që kjo pikë të kalojë për diskutim në Mbledhjen e radhës së Kuvendit, Nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

P e r f u n d i m

I. Aprovohet Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Gjakovës për vitin 2018

II. Ky përfundim së bashku me materialin dhe dokumentin e përgatitur të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës

5. Pika e Pestë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës së Gjakovës për vitin 2017

Kryesuesi : Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës së Gjakovës për vitin 2017, kjo pikë është obligim ligjor që të bëhet prezantimi Informatës Vjetore Financiare për vitin e kaluar më së largu deri me 31.Mars të vitit pasues , materialin e keni marrë me kohë andaj e ftoj Drejtorin e Drejtorisë për Buxhet dhe financa **z. Durim Halilaj** që të merr fjalën .

z. Durim Halilaj: Duke u bazuar në nenin 26 dhe 47 të Ligjit për menaxhimin e Financave Publike si dhe në rregulloren e MEF 03/2013 Drejtoria për Buxhet dhe financa prezanton pasqyrat vjetore Financiare për përdhën Janar – Dhjetor 2017 . Buxheti i aprovuar për vitin 2017 në Kuvendin e Komunës ka qenë 21.229.849,00€ e i cili ka pësuar ndryshime nga ai fillestarë donacione dhe participime 978,729.00€, mjetet të bartura nga viti paraprak 1.270.434,00€ buxheti i përgjithshëm i vitit 2017 ka qenë 23,473,289,00€ . Mjetet e alokuara nga grandit qeveritar ka qenë 17.607.865,00€, të cilat janë shpenzuar 16,978.000.00€ ose 96.39% e këtyre mjeteve dhe e kemi një suficit që ka ikur në buxhetin e republikës së Kosovës 635.997€ 3.031.029,00 € janë shpenzuar 2,026,574,00€ . Shpenzimet nga mjetet e bartura nga viti paraprak prej 1.270.434,00€ janë shpenzuar 1.080.000€ apo 85% e këtyre mjeteve , Nga donacionet 978,429,00€ janë shpenzuar 863,334,00€ 88.21% . Mjetet që kanë shkuar në Sufit nga grandit qeveritar janë nga Pagat dhe mëditje , mallra dhe Shërbime , komunalit dhe investimet kapitale . Komuna ka realizuar të hyra vetanake në vitin 2017 në vlerë prej 3.031, 029€ apo 83.28% e mjeteve të planifikuara, krahasuar me vitin 2016 kemi një rënjë prej 5.4 % . Borxhet e trashëguara fillimisht ju njoftoj se këto borxhe do të prezantojmë në mënyrë analitike në Kuvend dhe ato janë 4.212. 865,00€ të cilat krijojnë probleme enorme për shkak të tërheqjes së mjeteve nga përmbaruesit , gjithashtu kemi edhe obligim e kontraktuese që janë në vlerë prej 9 milion euro që në total janë mbi 13 milion euro borxhe të trashëguara nga qeverisja e kaluar . Komuna ka obligime të pa inkasuar nga qytetarët dhe operatorët ekonomik mbi 8.506.00,00€ . Në vitin 2017

përmes përmbartësive janë tërhequr mbi 800.000.00€ , kjo është një rezymë e shkurtër për informacione tjera jam në dispozicion .

Kryesuesi: Kjo informatë nuk është e mirëseardhur kur ne e dimë se për çdo ditë kemi përmbartës në Komunë dhe të na shkojnë të gjitha ato mjete në suficit kjo nuk është në rregull .
E hapi diskutimin për këtë pikë

Znj. Diana Qarkaxhja: Këtij raporti po i mungojnë pasqyrat financiare sepse në të kaluarën është prezantuar deri në 100 faqe ky raport sepse deri sa mungojnë pasqyrat financiare nuk është reale njëkohësisht në momentin kur thuhet 9 milion euro të tjera duhet të precizohet me saktësi për cilin projekt, sepse këtu janë llogaritur edhe projekte që janë të parapara për tri vitet e ardhshme sepse borxhi bëhet fiktiv ë momentin kur është ekzekutuar punimi. Vitet 2016-2017-2018-2019 janë të harmonizuara saktë se kur duhet të planifikuar , ka plot rrugë që janë nisur në qeverisjen e kaluar 2012 ose 13 siç është rruga e doblibares që ka filluar në vitin 2013 dhe ende është borxh , në Qeverisjen e fundit shumë nga ato projekte që kanë qenë të paplanifikuara nuk kanë mundur të realizohen sepse 22 milion kanë qenë borxh. Kërkoj që të prezantohen pasqyrat financiare që janë dërguar në Mistrinë e financave .

z. Durim Halilaj : E prezantova edhe më herë se borxhi prej janë 4.212. 865,00€ është borxh i bazuar në fatura marrëveshje të qeveris së kaluar , dhe janë specifikacionet , ndërsa 9 milion janë detyrime të kontratave ku shumica prej tyre as nuk janë të planifikuar në buxhet dhe kanë mbet kontrata që barten në vite .

znj. Diana Qarkaxhja: Shumica e këtyre kontratave janë nga ish qeverisje Lekaj dhe mjetet e përmendura në suficit kanë mbetur për shkak të mos rishikimit të buxhetit .

Kryesuesi: Kjo nuk shtatë e vërtetë dhe çdo herë mundet të del nga një arsyetim por këto mjete të mbesin në suficit në një buxhet të varfër kjo nuk donë koment dhe tregon më së mirë se çfarë menaxhimi i është bërë parasë publike, ka ndodhur suficit në paga që nuk ka mundur të ndodhë dhe ne i kemi marrë pagat në mjetet e parapara në vitin 2018 .

z. Durim Halilaj: Në muajin e fundit të viti nuk mundem me reagu në buxhet mirëpo kjo është një shumë e madhe që të shkojë në suficit nga mjetet e parapara për Paga dhe mëditje, por ka mos planifikim të saktë , nuk ka arsyetim për mjetet që kanë shkuar në suficit në mallra dhe shërbime ku e dimë se ka pasur mjaft obligime gjithashtu tek investimet kapitale ka pasur obligime dhe mjetet kanë mbetur në suficit .

z. Agon Batusha: Informatat financiare në të kaluarën kanë ardhur më voluminozë sepse këtu ka mungesë të të dhënave si psh. kujt i kemi borxh të jenë të specifikuara cilit operator të cilit vit janë , projektet e kontraktuara janë borxh 9 milion euro kjo ka qenë një praktik e qeverisjes së kaluar që një projekt të parashihet në tri vite që kërkoj që të ndërkehet kjo praktik e keqe , andaj kërkoj që të paraqitet në detaje ky borxh si dhe të prezantohet edhe tatimi në pronë se në secilën lagje sa kanë paguar, si dhe kërkojmë njoftim se nga cilat kode po tërhiqen mjetet nga thesari.

Znj. Florentina Gjergaj: Dua të ndërlidhem tek dokumentet voluminoze që nuk është domosdoshmëri që dokumentit jetë voluminoz që të ketë pasqyrim të saktë , pajtona që ky dokument duhet të plotësohet por nuk pajtohem se nuk ka informacione të nevojshme sa për tu kuptuar se kemi suficit dhe në anën tjetër kemi borxhe , kjo tregon se menaxhimi ka qenë i dobët dhe kërkohet tani dokumente voluminoze , një projekt që ballafaqona për çdo ditë është projekti i rrugës së fshatit Dobrixhe që janë planifikuar 60.000€ dhe janë alokuar 60.000€ dhe është realizuar 1005 ndërsa rruga është në gjendje të mjerueshëm . Sa i përket pasqyrave financiare për mua si profesioniste për mua janë të mjaftueshëm por tek rekapitullimi i kisha shtuar një rekapitullim më të zgjeruar në mënyrë që të kuptohen nga të gjithë.

z. Agon Batusha: Pajtona me parafolësen për shpenzimet e letrave por nëse është e informuar se ku janë 9 milion euro borxh është në rregull por ne që nuk jemi të informuar duhet të kemi këto informata, dhe nuk mundet askush të na ofendoj se nuk dimë apo nuk i po i kuptoni këto dokumente.

Znj. Florentina Gjergjaj: Nuk ke qëllimi me e ofenduar askënd dhe për mua është normale me kuptua informata dhe sqarime shtesë dhe nuk pata për qëllim që ta ofendoj askënd.

z. Bekim Ermeni: Për mbledhjen e ardhshme kërkoj që të prezantohen analitika e borxhit 4.1 dhe analitika e borxhit 9 milion e veçante, si dhe për suficitin e mbetur është logjike për amator të thuhet se paret i kemi pasur dhe borxhe kemi pasur dhe kanë mbetur mjetet suficit dhe i ka marrë qeveria, andaj kërkojmë analitik për suficitin cilat projekte kanë qenë të përfunduara me raport dhe nuk janë paguar mjetet të kemi një analitik, e nëse kjo ka ndodhur kjo është skandal, por problemi është se operatori ekonomik nuk i ka ndjekur procedurat dhe mjetet kanë mbetur në suficit.

Kryesuesi: Kjo me të vërtetë është skandal sepse nuk janë ndjekur procedurat nga drejtoritë dhe nuk janë përfunduar projektet kjo është keq menaxhim i skajshëm. Si sqarohet ndryshe tek drejtoria për Kulturë ka mjete të shumta borxhe tek komunalit dhe mjetet në këtë kategori ka n shkuar suficit.

z. Fazli Hoxha: E përgëzoj drejtorin për prezantimin e këtyre pasqyrave financiare, dhe kërkoj që mos të kërkohej llogari nga anëtarët e ish qeverisjes, sepse me pa punuar mirë e kishit marrë prapë besimin e qytetarëve. znj. Qarkaxhia nuk mundet të përgjigjet për të gjitha fushat sepse kjo e ka drejtuar dikasterin e arsimit e jo tani të merr përsipër të gjitha përgjegjësitë kështu që ne duhet të mësojmë nga gabimet e tyre e mos të bëjmë të njëjtat gabime.

z. Bekim Jupa: Unë kërkoj që të kemi etikë dhe të respektojmë gjithsecilin sepse të gjithë e kemi integritetin tonë personal. Në tabelën nr 8 shpenzimet enorme që kanë ndodhur nga viti në vit siç janë shpenzimet e telefonisë mobile dhe kemi trefishim të këtyre shpenzimeve nga viti në vit. Andaj dueht të sugjerojmë këtij ekzekutivi që ti zvogëloj këto shpenzime. Shpenzimet e telefonave më pak se 1000€ çka nënkupton kjo, tjetër makina fotokopjuese në vitet 2014 dhe 2015, janë prezantuar shpenzimet ndërsa në 2016 dhe 2017 nuk janë prezantuar fare figuron 0 atëherë me ka funksionuar komuna ë këto dy vite, kemi një pikë furnizim me ushqim dhe pije një kolon më posht shënon dreka zyrtare, andaj po na prezantohen shumë shpenzime me ka një term të ndryshuar andaj kërkojmë që të jenë të sqaruara të gjitha këto shpenzime.

z. Haxhi Sejdiu: Lidhur me shërbimet kontraktuese që janë duke u rritur nga viti në vit kërkoj sqarime si dhe tek drekat zyrtare nëse hekën pushimet vjetore dhe festat zyrtare po i bije harxhime diku rreth 200€ në ditë shpenzime për dreka zyrtare, kërkojmë sqarime lidhur me këto shpenzime se ku po shkojnë mjetet e taksapaguesve tonë.

znj. Florentina Gjergjaj: Tek mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve kemi një regres gjatë viteve ku ne vitin 2017 është 13.511.18 € në vitin 2014 është 21.151€ mendoj se mirëmbajtja e makinave të komunës me amortizimin e tyre normal duhet të rritem ndërsa këtu po e shoh një diçka që po zbritet.

z. Agon Batusha: Unë po ndërlidhemi nga provoja ime sepse etani qe dy mandate jam anëtar sepse në të kaluarën edhe unë kamë për kritika jo të bazuara dhe pasi e kamë pranuar përgjigjejen jam bindur se jam gabim. Andaj është mirë që të kemi më shumë informata ne mënyre që të jemi të informuar dhe mos të bëjmë kritika pa baza.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime e qes në votim që kjo pikë të kaloj për diskutim në Mbledhjen e radhë së Kuvendit, Nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

P ë r f u n d i m

I. Aprovohet Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës së Gjakovës për vitin 2017

II. Ky përfundim së bashku me materialin dhe dokumentin e përgatitur të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës

6. Pika e Gjashtë e rendit të ditës : Bartja (rialokimi) i buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin 2018

Kryesuesi: Edhe kjo pikë është kërkesë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa që ka të bëjë me rialokimin e mjeteve të pa shpenzuara nga viti i kaluar në këtë materialin e keni marrë me kohë andaj e ftoj Drejtorin e Drejtorisë për Buxhet dhe financa z. Durim Halilaj që të merr fjalën.

z. Durim Halilaj: Drejtoria për Buxhet dhe financa ka parashtruar kërkesën për dislokimin e mjeteve të pa shpenzuara nga vitit 2017 në buxhetin e vitit 2018 në vlerë prej 1.194.640.00€ bashkangjitur i gjeni shkresat që janë përgatitur me të gjitha të dhënat për këtë rialokim sipas kategorive të prezantuara në këto dokumente .

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë

z. Haxhi Sejdiu: Tek kodi 432623 sanimi apo ndërtimi i rrugëve të asfaltuara ka mjaft rrugë me u sanu dhe mjete paskan tepruar në vlerë prej 140.000€

z. Durim Halilaj: Këto mjete janë roialokuar në këtë kod nuk janë mjete që janë mbetur por janë mjete të reja të bartura .

Kryesuesi: Edhe kjo kërkesë ka të bëjë me Shndërrimin e tokës Bujqësore në Jo bujqësore andaj, Drejtorin e Drejtorisë Për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural z. Shpat Nivokazi e bërë prezantimin e kësaj pike edhe në pikën paraprake nëse nuk keni diçka për me diskutuar po e kalojmë edhe këtë pikë .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime e qes në votim që kjo pikë të kalojë për diskutim në Mbledhjen e radhës së Kuvendit, Nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

P ë r f u n d i m

I. Aprovohet Bartja (rialokimi) i buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin 2018

II. Ky përfundim së bashku me materialin dhe dokumentet e përgatitur të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës

7 Pika e shtatë e rendit të ditës: Themelimi i Komitetit për Shërbime Publike (KPSH).

Kryesuesi: Kjo pikë ka të bëjë me kërkesën për themelimin e Komitetit për Shërbime Publike i cili ka qenë edhe në të kaluarën dhe ka qenë në partneritet të mirë me DEMOS dhe ka luajtur një rol të mirë lidhur me projektet e rëndësishme nga Fusha e Shërbimeve Publike , dhe i ka 5 anëtar andaj kemi menduar që të formohet edhe në këtë mandat .

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime e qes në votim që kjo pikë të kaloj për diskutim në Mbledhjen e radhë së Kuvendit, Nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

P ë r f u n d i m

I. Aprovohet kërkesa për Themelimin e Komitetit për Shërbime Publike (KPSH)

II. Ky përfundim të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës

8. Pika e tetë e rendit të ditës: Themelimi i Komisionit të Ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale .

Kryesuesi: Kjo pikë është një obligim ligjor Themelimi i Komisionit të Ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, i cili ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me ankesat që bëhen kundër vendimeve të Komisionit për dhënien në Shfrytëzim të pronave Komunale, edhe ky komision duhet të ketë gjithsejtë 5 anëtar .

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime e qes në votim që kjo pikë të kaloj për diskutim në Mbledhjen e radhë së Kuvendit, Nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

P ë r f u n d i m

I. Aprovohet kërkesa për Themelimi i Komisionit të Ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale

II. Ky përfundim të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës

9. Pika e nëntë e rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 910/0, Zk Firzë në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi shqyrtimin Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 910/0, Zk Firzë në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).e ftojme drejtorin e DUMM-së z. Arben Bakalli që të bëjë sqarimin e kësaj pike .

z. Arben Bakalli: Pranë drejtorisë për Urbanizëm kanë ardhur kërkesat për dhënien e lejes për vendosjen e stabilimenteve të rrymës elektrike dhe për lejimin e shfrytëzimit të pronës komunale, 2 kreka janë të parapara të vendosen në oborret e shkollave njëra në Dol dhe tjetra në fshatin Cermjan, ndërsa njëra do të vendoset prapa pallatit në Qender dhe njëra në Firez, dhe në Trakaniq , me këtë çështje është marrë zyrtari z., Lulzim Haxhiu që mundet më në detaje të na sqaron këto pozicione.

z. Lulzim Haxhiu: Kjo çështje është e rregulluar me ligjin mbi energjinë që KEDS para se të vendos këto pajisje ti drejtohet komunës për pronat komunale që të kërkoj shfrytëzimin e pronave të komunale, kemi 5 kërkesa dhe u cek se 2 raste janë në oborret e shkollave ndërsa 3 raste janë në Takaniq , në Firzë dhe në Gjakovë . Këto stabilimente për momentin e kryejnë funksionin e ndaljes së rrymës vetëm në një drejtim e jo në komplet linjën dhe dy nga to e kryejnë funksionin edhe të trafo stacionit , dhe njëri është në shkollën e Dolit dhe tjetri në Gjakovë që është i vendosur në Bodrum të banesave

z. Agon Batusha: Në fshatin Dol ajanë dy pozicione në hartë ndërsa do të vendoset vetëm një trafo si është problemi, si dhe në Firez a përfshihet parcela që do të epet në shfrytëzim për fushat e sportit apo si qëndron puna .

z. Lulzim Haxhiu: Janë dy pozicione sepse do të heket e vjetra, ndërsa në Firëz është menjëherë nga rruga e djathtë nga Brekoci ,

z. Agon Batusha: KEDS nuk paguan edhe pse i shfrytëzon hapësirat Publike dhe është kompani private, dhe përmes këtyre kompania përfiton, andaj është mirë që të gjendet një zgjidhje dhe të lirohet nga pagesa e rrymës ajo pjesë që të përfitoj edhe komuna nga prona e vetë .

Kryesuesi: Kjo është në interes të qytetarëve sepse investimi po ndodhë për stabilizimin e rrymës në mënyrë që qytetarët mos të kenë probleme me furnizim të mirë me rrymë elektrike.

z. Bekim Ermeni: Kemi dy forma të dhënies në Shfrytëzim të pronave dhe ky rast ka të bëjë me afatgjatë dhe janë disa mundësi që të definohet në kontratë disa elemente . Por kam një pyetje për vendosjen e dy trafave në oborrin e shkollave a ka mundësi që të largohen nga oborret e shkollave sepse potencialisht është rrezik të ketë trafo në oborrin e shkollave

z. Lulzim Haxhiu: Këto stabilimente ente vendosen aty ku janë lartë përçuesit dhe në këto oborre të shkollave janë trafotë por vetëm janë dislokuar në kënde ku nuk pengon .

znj. Diana Qarkagjija: Emrat e Shkollave që nga viti 2012 Janë ndryshuar dhe nuk është shkolla “Vllaznimi” në Cermjan por tani është “Ali Hasi”, dhe në Dol është “Anton Qeta” , andaj mendoj se duhet të përmirësohet mos të ndodhë ndonjë gabim .

Kryesuesi: Kërkoj që të harmonizohen këto dokumente dhe të specifikohet edhe baza ligjore me të dhënat e sakta dhe me afatin e caktuar për sa viti kërkohen .

z. Bekim Jupa : Unë i kamë dy vërejtje sepse këtu i kemi dy vendime a është e para letërpërcjellëse apo çfarë është kjo, ku në këtë jeni thirrur me bazë ligjore e me të gjitha ndërsa në propozim vendim nuk jeni thirrur në asnjë bazë ligjore, andaj shtone një paragraf dhe thirrreni në bazë ligjore dhe të jetë lënda e kompletuara .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime e qes në votim që kjo pikë të kalojë për diskutim në Mbledhjen e radhës së Kuvendit, Nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

P ë r f u n d i m

I. Aprovohet kërkesa e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 910/0, Zk Firëz në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

II. Ky përfundim së bashku me dokumentet përcjellëse të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës

10. Pika e dhjetë e rendit të ditës : Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 164/0, Zk Trakaniq në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

Kryesuesi: Edhe kjo pikë ka të bëjë me kërkesën e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 164/0, Zk Trakaniq në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2). ftojme drejtorin e DUMM-së

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë.

E qes në votim që kjo pik e rendit të ditës të diskutohet dhe në Mbledhjen e radhës së Kuvendit, Kush është për, Kundër dhe, Abstenim Nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

P ë r f u n d i m

I. Aprovohet kërkesa e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 164/0, Zk Trakaniq në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

II. Ky përfundim së bashku me dokumentet përcjellëse të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës

11. Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës : Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1186/0, Zk Cermjanë në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

Kryesuesi: Edhe kjo pikë ka të bëjë me kërkesën e KEDS-it Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1116/2, Zk Gjakovë qytet në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2)

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë.

E qes në votim që kjo pik e rendit të ditës të diskutohet dhe në Mbledhjen e radhës së Kuvendit, Kush është për, Kundër dhe, Abstenim Nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

P ë r f u n d i m

I. Aprovohet kërkesa e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1186/0, Zk Cermjanë në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

II. Ky përfundim së bashku me dokumentet përcjellëse të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës

12. Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës : Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1116/2, Zk Gjakovë qytet në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

Kryesuesi: Edhe kjo pikë ka të bëjë me kërkesën e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1116/2, Zk Gjakovë qytet në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit(2.6x5.2). andaj e ftojme drejtorin e DUMM-së Arben Bakalli që të bëjë sqarimin e kësaj pike

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë.

E qes në votim që kjo pik e rendit të ditës të diskutohet dhe në Mbledhjen e radhës së Kuvendit, Kush është për, Kundër dhe, Abstenim Nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

Përfundim

I. Aprovohet kërkesa e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1116/2, Zk Gjakovë qytet në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

II. Ky përfundim së bashku me dokumentet përcjellëse të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës

13. Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës : Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 113/0, Zk Pjetërshan në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

Kryesuesi: Edhe kjo pikë ka të bëjë me kërkesën e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 113/0, Zk Pjetërshan në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2 andaj e ftojme drejtorin e DUMM-së Arben Bakalli që të bëjë sqarimin e kësaj pike

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë.

E qes në votim që kjo pik e rendit të ditës të diskutohet dhe në Mbledhjen e radhës së Kuvendit, Kush është për, Kundër dhe, Abstenim Nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

Përfundim

I. Aprovohet kërkesa e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 113/0, Zk Pjetërshan në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e stabilimenteve Shpërndarëse të dimensionit (2.6x5.2).

II. Ky përfundim së bashku me dokumentet përcjellëse të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës

14. pika e dhjetë e rendit të ditës : Të ndryshme

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë diskutim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës .

z. Agon Batusha: U tha edhe me herët se Faqja zyrtare e Komunës nuk është duke funksionuar dhe nuk mundemi ti publikojmë konkurset që i shpall komuna ndërsa në anën tjetër janë shumë konkurse që po vazhdojnë të procedohen dhe ka shumë vërejtje nga qytetarët dhe është e nevojshëm që të njoftohem për ecurit e këtyre konkurseve sepse kemi njoftime që janë anuluar disa konkurse dhe duhet të jemi të informuar pse janë anuluar. Për ndërmarrjet publike ju ka kaluar mandati bordeve të drejtorëve si dhe Drejtorive ju ka kaluar andaj kërkojmë që të jemi të informuar për këto procedura .

z. Bekim Jupa: Në NPK Çabratit sot e kemi një takim si komision komunal i aksionareve së bashku me Zyrën ligjore lidhur me procedurat e hapjes së Konkursit dhe shpresoj se më së largu nesër do të hapet konkursi për Bordin e drejtorëve të kësaj ndërmarrje .

Bekim Ermeni: Unë propozoj që për mbledhjen e Kuvendit ti kemi edhe dy pika të rendit të ditës njëra ka të bëjë me Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2018 që të kemi një planë se si do të punohet gjatë këtij viti dhe pika tjetër ka të bëjë me Planin e punës së Kryetarit të Komunës dhe qeverisjes komunale për këtë vite si do të punoj cilat janë projektet cilat janë prioritetet skema e Subvencioneve dhe kur planifikohen të kryhen .

Kryesuesi: Për të dyja pikat nuk kemi mundësi për këtë mbledhje por së shpejti do të kemi takime me DEMO-s dhe do të hartojmë një Plan të Punës Kuvendit dhe besoj se për mbledhjen e tjetër të radhës do të prezantojmë para jush , sa i përket Planit të Punës është Ekzekutivit do ta diskutojmë me Kryetarin dhe shohim se si do të veprojmë .

z. Agon Batusha: Në mbledhjen e fundit kryetari ka premtuar se do të na prezanton raportin financiar sidomos pasqyrën e borxheve që kanë mbetur nga qeverisja e kaluar .

znj. Hana Zeka: Kërkojmë që në mbledhjen e radhës së Kuvendit të prezantohet raporti mbi borxhet që janë trashëguar me të gjitha faktuarat dhe argumentet e këtij Borxhi.

Znj. Diana Qarkaxhia: Kërkoj që të na dërgohet një raport lidhur me punën e komisionit për Strehim që nga dita e themelimit dhe të prezantohet e gjithë puna që është bërë në këtë komision

Kryesuesi: Ky komision ka vepruar në mandatin e kaluar dhe ne nuk mundemi që të veprojmë ashtu shpejt e shpejt për shkak të kërkesave tuaja sepse e keni pasur mundësi edhe më herët e jo tani në këtë fillim të punës sonë, ku ju 4 vite nuk keni qenë në gjendje me hulumtuar dhe me vepruar.

z. Bekim Ermeni : Unë kam një pyetje se për këto kërkesat që sapo i parashtrova a duhet të hedhen në votim për mbledhjen e radhës apo si duhet të veprohet .

Kryesuesi: Mbledhja e Kuvendit do të thirret nesër dhe ne nuk kemi mundësi që për këtë mbledhje të fusim në rend dite edhe këtë kërkesë sepse është teknikisht e pa mundur , ndërsa për raportin e Kryetari

z. Bekim Jupa : Për çështje të banimit social, sepse në të gjitha mbledhjet e Kuvendit është diskutuar për këtë temë , andaj ne duhet të kemi një pasqyre reale për këtë çështje kush është anëtar i këtij komisioni , kush ka përfituar. Sa mi përket kërkesave është mirë që të bëhet në emër të grupit dhe ti drejtohen Kryesuesit për pikat e rendit të ditës .

Mbledhja u shpall e mbyllur në ora 12:00

Procesmbajtës,

Burim Bajrami

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z. Anton Shala